



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E VËZHguesVE AFATGJATË TË OSBE/ODIHR NË ZGJEDHJET**  
**PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 24.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimi i vëzhguesve afatgjatë nga OSBE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

ODIHR është një prej organizatave të krijuara në kuadrin e OSBE, duke u kthyer që me themelimin e saj në organizmin kryesor të monitorimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

ODIHR monitoron përmes vëzhguesve, zgjedhjet në vendet anëtarë të OSBE-së duke patur parasysh kriteret e lirive themeltare, universalizmit, pluralizmit politik, besimit, transparencës dhe përgjegjshmërisë. Në këtë kuptim ODIHR mbështetet në një metodologji sistematike dhe afatgjatë vëzhgimi me qëllim përmirësimin e proceseve zgjedhore përmes raporteve post-zgjedhore dhe asistencës teknike.



**Nr. 648 i Vendimit**

**Data 24.05.2019**

**Ora. 13:30<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 32 (tridhjetë e dy) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e OSBE/ODIHR, për akreditimin e 32 (tridhjetë e dy) vëzhguesve afatgjatë, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>

